



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI

*Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

Dokument parlamentar

Tiranë, më 29/08/ 2014

**R A P O R T**

**PËR DEKRETIN E PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS, NR.8679, DATË 15.08.2014  
“PËR KTHIMIN E LIGJIT NR. 101/2014 “PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.  
8811, DATË 17.05.2001, “PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KËSHILLIT TË LARTË TË  
DREJTËSISË”, I NDRYSHUAR”**

**1.0 HYRJE**

Komisioni i Ligjeve, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 29/08/2014, mori në shqyrtim dekretin e Presidentit të Republikës, **nr.8679, datë 15.08.2014 “PËR KTHIMIN E LIGJIT NR. 101/2014 “PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 8811, DATË 17.05.2001, “PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË”, I NDRYSHUAR”**.

Komisioni i Ligjeve e shqyrtoi këtë projektligj në zbatim të nenit 86 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Komisioni caktoi relator deputetin Armando Subashi. Për të zhvilluar procedurën e shqyrtimit të dekretit, Kuvendi me shkresë zyrtare ftoi përfaqësues nga Presidenca, të cilët pa njoftuar ndonjë arsye nuk u paraqitën në mbledhje.

**2.0 ARSYET PËR KTHIMIN E LIGJIT SIPAS DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS**

Me Dekretin nr.8679, datë 15.08.2014, Presidenti i Republikës vendosi kthimin e ligjit nr.101/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8811, datë 17.05.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar”.

Nisur nga përmbajtja e materialit shpjegues të Dekretit të Presidentit të Republikës, rezulton se arsyet për kthimin e ligjit janë si më poshtë vijon:

- a) Ndryshimi që sjell neni 7 i ligjit nr. 101/2014, duke parashikuar se “*Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me propozim të Presidentit, zgjedh nga radhët e anëtarëve të zgjedhur nga Kuvendi një Zëvendëskryetar*”, bie ndesh me nenin 147 pika 3 të Kushtetutës.
- b) Ky ndryshim përbën shkelje të parashikimeve kushtetuese në dy plane:

- Kufizon kompetencën e Presidentit të Republikës, në cilësinë e Kryetarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, për të propozuar si Zëvendëskryetar cilindo nga anëtarët e këtij Këshilli, dhe
- Heq të drejtën që i ka dhënë Kushtetuta anëtarëve nga radhët e gjyqësorit për t'u propozuar në postin e Zëvendëskryetarit të KLD-së.

Kushtetutëbërësit e kanë lënë në vlerësimin e Presidentit të Republikës dhe të Këshillit të Lartë të Drejtësisë zgjedhjen e Zëvendëskryetarit, i cili mund të jetë si nga radhët e gjyqtarëve të zgjedhur nga Konferenca Kombëtare Gjyqësore ashtu edhe nga radhët e anëtarëve të zgjedhur nga Kuvendi.

- c) Neni 147, pika 3 e Kushtetutës nuk përmban elementët e një norme referuese, por është një normë që kërkon zbatim të drejtpërdrejtë, pra me anë të kësaj dispozite kushtetutëbërësi e ka marrë vetë përsipër të rregullojë zgjedhjen e Zëvendëskryetarit të KLD-së. Ligjvënësi mund të bëjë shtesa dhe ndryshime në ligje, por pa cenuar rregullimet tepër specifike kushtetuese për natyrën e funksionimit dhe përbërjen e Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Nisur nga përmbajtja e nenit 7 të ligjit nr. 101/2014, ndaj bindjen se miratimi i kësaj dispozite duhej të ishte paraprirë minimalisht nga vullneti i ligjvënësit për të ndryshuar pikën 3 të nenit 147 të Kushtetutës.
- d) Edhe në rast se njëri nga gjyqtarët zgjidhet nga KLD si Zëvendëskryetar, ai vazhdon të jetë përfaqësues i pushtetit gjyqësor me ndryshimin e vetëm se ai nuk mund të ushtrojë funksionin e gjyqtarit për kohëzgjatjen e mandatit. Ai e rifillon ushtrimin e dhënies së drejtësisë në gjykatë pasi ka dhënë dorëheqjen ose ka përfunduar mandatin si zëvendëskryetar.
- e) Përderisa, gjyqtari nuk e humbet këtë cilësi përveç rasteve të parashikuara shprehimisht nga Kushtetuta, atëherë nuk mund të pretendohet se me zgjedhjen e tij si Zëvendëskryetar nuk përfaqëson trupën gjyqësore nga e cila është zgjedhur.
- f) Për sa më sipër, ndryshimet ligjore tejkalojnë parashikimet kushtetuese duke cenuar parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve si dhe parimin e hierarkisë së normave. Referuar jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese *“atë që nuk ka dashur ta bëjë Kushtetuta nuk mund ta bëjë ligji. Prandaj nuk mund të pranohet se ajo ka ometuar pa përmendur raste të tilla ...”*.

### **3.0. BAZA LIGJORE PËR SHQYRTIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS**

#### **3.1 Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë:**

*Neni 85*

1. *Presidenti i Republikës ka të drejtë ta kthejë ligjin për rishqyrtim vetëm një herë.*
2. *Dekreti i Presidentit për rishqyrtimin e një ligji e humbet fuqinë, kur kundër tij votojnë shumica e të gjithë anëtarëve të Kuvendit.*

#### **3.2 Jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese lidhur me çështjen në fjalë:**

*Vendim nr.14/2006 i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.*

### 3.3 Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë

Neni 86

*Dekreti i Presidentit të Republikës për rishqyrtim ligji*

1. Kur Presidenti i Republikës, në përputhje me nenin 85 të Kushtetutës, rikthen ligjin për rishqyrtim në Kuvend, Kryetari i Kuvendit e kalon menjëherë atë për shqyrtim në komisionin përgjegjës që e ka shqyrtuar fillimisht.
2. Komisioni përgjegjës e shqyrton dekretin vetëm për çështjet e paraqitura nga Presidenti i Republikës dhe brenda 8 javëve nga data e fillimit të shqyrtimit paraqet raportin e tij. Ky raport përmban mendimin e komisionit dhe, sipas rastit, edhe propozime për nene të veçanta të ligjit.

### 4.0 SHQYRTIMI I ARSYEVE TË KTHIMIT TË LIGJIT

Në arsyetimin e dekretit për kthimin e ligjit nr.101/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8811, datë 17.05.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar”, Presidenti i Republikës ka parashtruar disa arsye, ku bazon përfundimin e tij se dispozitat e këtij akti bien ndesh me Kushtetutën.

4.1 Presidenti i Republikës pretendon se ndryshimi i përmbajtjes së nenit 12 të ligjit organik të Këshillit të Lartë të Drejtësisë (neni 7 i ligjit nr.101/2014) bie ndesh me Kushtetutën dhe përkatësisht me përmbajtjen e pikës 3 të nenit 147 të saj, ku parashikohet se: “*Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me propozim të Presidentit, zgjedh nga radhët e anëtarëve të zgjedhur nga Kuvendi një Zëvendëskryetar*”.

Sipas Presidentit të Republikës, fakti që në ligji tashmë parashikohet që Zëvendëskryetari i Këshillit të Drejtësisë propozohet dhe zgjidhet nga radhët e anëtarëve të zgjedhur nga Kuvendi i Shqipërisë, nga njëra anë kufizon kompetencën e tij për të propozuar në këtë detyrë secilin prej anëtarëve, nga ana tjetër, u heq të drejtën kushtetuese anëtarëve të zgjedhura nga Konferenca Kombëtare Gjyqësore për të kryer këtë detyrë.

Sipas Presidentit, ky parashikim ligjor nuk mund të ekzistojë përsa kohë nuk është ndryshuar përmbajtja e pikës 3 të nenit 147 të Kushtetutës, dispozitë kushtetuese kjo që nuk është e karakterit referees dhe si e tillë është drejtpërsëdrejti e zbatueshme.

Në bindjen e Presidentit, në rast se njëri nga anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i zgjedhur nga Konferenca Kombëtare Gjyqësore, për shkak të qenies gjyqtar, zgjidhet si Zëvendëskryetar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ai vijon ta gëzojë këtë cilësi dhe do e rifillojë ushtrimin e detyrës së tij si gjyqtar me mbarimin e mandatit ose dhënien e dorëheqjes nga detyra e Zëvendëskryetarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Përpara se të bëjmë një analizë të arsyes që ka shtyrë Presidentin e Republikës për të kthyer ligjin nr.101/2014, e gjejmë të nevojshme të bëjmë një analizë të dispozitave përkatëse të Kushtetutës dhe ligjit organik të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, me qëllim argumentimin e qëndrimit të Komisionit të Ligjeve ndaj dekretit presidencial të vetos pezulluese.

Në nenin 143 të Kushtetutës parashikohet shprehimisht se: “*Qenia gjyqtar nuk pajtohet me asnjë veprimtari tjetër shtetërore, politike ose private.*”

Ndërkohë pika 1 dhe 3 e nenit 147 të Kushtetutës kanë këtë përmbajtje: “1. Këshilli i Lartë i Drejtësisë përbëhet nga Presidenti i Republikës, Kryetari i Gjykatës së Lartë, ministri i Drejtësisë, 3 anëtarë të zgjedhur nga Kuvendi, si dhe 9 gjyqtarë të të gjitha niveleve, të cilët zgjidhen nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare. Anëtarët e zgjedhur qëndrojnë në detyrë për 5 vjet pa të drejtë rizgjedhjeje të menjëhershme... 3. Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me propozim të Presidentit, zgjedh nga radhët e tij një zëvendëskryetar. Zëvendëskryetari organizon veprimtarinë e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, si dhe kryeson mbledhjet e tij në mungesë të Presidentit të Republikës.”

Në referim dhe në zbatim të nenit 143 të Kushtetutës, në nenin 22 të ligjit nr.9877/2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” janë sanksionuar papajtueshmëritë me detyrën e gjyqtarit me këtë formulim: “**Papajtueshmëritë me detyrën e gjyqtarit** - Gjyqtari nuk mund të ushtrojë asnjë veprimtari tjetër shtetërore, private ose politike.”

Shkronja “c” e nenit 7 të ligjit nr.8811, datë 17.05.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar, parashikon si një ndër rastet e mbarimit të mandatit të anëtarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, kur “c) nuk është më gjyqtar, nëse është zgjedhur nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare;”.

Neni 12 i ligjit nr.8811, datë 17.05.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar, ka pasur këtë formulim: “**Neni 12 - Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë - 1.** Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me propozim të Presidentit, zgjedh nga radhët e tij një Zëvendëskryetar.

2. Zëvendëskryetari organizon veprimtarinë e përditshme të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.
3. Në rastin kur është zgjedhur nga radhët e anëtarëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë që janë gjyqtarë, Zëvendëskryetari, për kohën që shërben në këtë detyrë, nuk e ushtron funksionin e gjyqtarit.
4. Në rastin e dorëheqjes ose të mbarimit të mandatit, Zëvendëskryetari rifillon ushtrimin e funksionit të gjyqtarit në gjykatën ku ka qenë i emëruar ose, me pëlqimin e tij, në një gjykatë tjetër.”

Ndërsa me miratimin e ligjit nr.101/2014, ky nen tashmë do të ketë këtë formulim: “1. Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me propozim të Presidentit, zgjedh nga radhët e anëtarëve të zgjedhur nga Kuvendi një Zëvendëskryetar.  
2. Zëvendëskryetari organizon veprimtarinë e përditshme të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.”

Sipas arsytimit të bërë në dekretin për kthimin e ligjit nr.101/2014, cënimi i normës kushtetuese ka të bëjë pikërisht me përcaktimin e rrethit të anëtarëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, mes të cilëve Presidenti i Republikës duhet të përzgjedhë dhe propozojë Zëvendëskryetarin e këtij organi kushtetuese.

Konstatohet se në këtë arsyetim jo të plotë të dekretit, Presidenti i Republikës nuk i është referuar një burimi tjetër po aq të rëndësishëm, por edhe të detyrueshëm të së drejtës, siç është jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, e veçanërisht vendimi nr.14, datë 22.05.2006.

E çmojmë të nevojshme të sjellim në vëmendje të Presidentit të Republikës se, bazuar në pikën 1 të nenit 124 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Gjykata Kushtetuese është garante e respektimit të Kushtetutës dhe bën interpretimin përfundimtar të saj. Është detyrë e organeve kushtetuese dhe, për më tepër, e Presidentit të Republikës, veçanërisht kur arsyetohet

mbi kthimin e ligjeve në Kuvend, që t'i referohen jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese, në vijimësi dhe jo në mënyrë selektive.

Nisur nga ky koncept kushtetues, Presidenti i Republikës përpara se të dekretonte kthimin e ligjit nr.101/2014 kishte detyrimin, në radhë të parë, për të qenë i informuar mbi këtë vendimmarrje kushtetuese, me qëllim nxjerrjen e konkluzioneve të sakta mbi interpretimin që Gjykata Kushtetuese i ka bërë nenit 147 të Kushtetutës dhe në veçanti pozicionit që kanë anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, të cilët zgjidhen nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare.

Presidentit të Republikës në këtë kuadër, do t'i kishte mjaftuar të kujtonte qëndrimin e mbajtur prej tij, në vitin 2012, kur ka propozuar për Zëvendëskryetar të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, pikërisht njërin nga anëtarët e këtij organi, i zgjedhur nga Kuvendi i Shqipërisë, duke lënë pa fuqi juridike zgjedhjen që kishte bërë paraardhësi i tij.

Vetë Presidenti i Republikës në atë kohë përpos faktit të propozimit në detyrën e Zëvendëskryetarit të KLD të një anëtari të këtij organi të zgjedhur nga Kuvendi i Shqipërisë, ka mbajtur një qëndrim publik në mbrojtje të këtij propozimi. Në këtë qëndrim, Presidenti i Republikës argumenton pikërisht të kundërtën e sa parashtron 2 vjet më pas në arsyetimin e kthimit të ligjit nr.101/2014. Në intervistën e datës 29 nëntor 2012, dhënë një televizioni kombëtar, Presidenti i Republikës shprehet se: *“Së pari ka qenë një ndjekje dhe një respektim i procedurës le të themi i asaj tradite që ka ekzistuar vazhdimisht në Këshillin e Lartë të Drejtësisë. Që do të thotë: për shkak se përbërja e Këshillit të Lartë të Drejtësisë është një përbërje nga përfaqësues të institucioneve të ndryshme, ku shumica vendimmarrësve i takon gjyqtarëve. Pra nga 15 anëtarë, dhjetë vijnë nga trupa gjyqësore, janë gjyqtarë. Tre janë nga Parlamenti. Në krye të Këshillit të Lartë të Drejtësisë është Presidenti i Republikës, i cili ka të drejtën e vetos në mjaft raste dhe vendime të rëndësishme të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, qeveria përfaqësohet me Ministrin e Drejtësisë si anëtar “ex-oficio” i Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Dhe tradita ka qenë që në këtë përbërje ku shumica vendimmarrëse i takon gjyqtarëve, ku Kreu i Shtetit është kreu i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, nënkryetari gjithmonë në balancë të përfaqësimit të institucioneve, ka qenë në traditë që të jetë përfaqësues i ardhur nga Parlamenti, pra i zgjedhur nga Parlamenti.”*<sup>1</sup>

Në çdo rast, referimi tek ky vendim i Gjykatës Kushtetuese do të kishte qenë i mundur për Presidentin e Republikës, edhe në qoftë se do të kishte lexuar raportin shoqëruar të ligjit nr.101/2014, hartuar nga Komisioni i Ligjeve, dokument parlamentar publik.

Duke iu referuar raportit në fjalë, Presidenti i Republikës mund të kishte konstatuar lehtësisht se përfundimet e radhitura në arsyetimin e dekretit për kthimin e ligjit nr.101/2014 nuk janë të bazuara asfajë në Kushtetutë.

Duke iu referuar dhe dispozitave kushtetuese dhe ligjore të renditura më lart në këtë material, e gjejmë me vend të rirëndisim argumentat kushtetues dhe ligjorë, mbi të cilat është mbështetur Kuvendi i Shqipërisë në ndryshimin e përmbajtjes së pikës 1 të nenit 12 të ligjit organik të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Ndryshimet e propozuara në nenin 12 të ligjit ekzistues janë imponuar për shkak të qenies në përputhje dhe në harmoni të plotë me qëndrimin e mbajtur nga Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 14, datë 22.05.2006, që ka gjetur konkretizim edhe në precedentin e vendosur

---

<sup>1</sup> <http://president.al/?p=4286>

nga Presidenti i Republikës, në rastin e debatit të shkaktuar për caktimin e ZëvendësKryetarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, nga radhët e gjyqtarëve.

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese ka orientuar ligjvënësin për mosdeformimin e formulës kushtetuese të KLD-së [ $1 + (9+1) + 1 + 3 = 15$ ] dhe ruajtjen e balancës ndërmjet pushteteve, në veçanti sa i takon mosndryshimit të numrit të gjyqtarëve, si dhe mosshndërrimit të tyre në funksionar me kohë të plotë, që i shmang ata nga kryerja e detyrës së gjyqtarit.

Në arsyetimin e saj, Gjykata Kushtetuese identifikon qartësisht pengesën kushtetuese për zgjedhjen e zëvendës kryetarit të KLD-së nga radhët e gjyqtarëve, kur vlerëson se :

*“Kushtetuta nuk i ka shkëputur anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë nga gjykimi dhe, si rrjedhojë, as nga interesat e trupës gjyqësore.”*

• *“...Përderisa Kushtetuta në fuqi e ka bërë vetë specifikimin, duke i quajtur gjyqtarë, nuk mund të vendosen emërtime të tjera, të cilat mund të shtojnë ose të pakësojnë cilësi të tjera dhe që çojnë në përbërje të ndryshme nga përbërja që ajo përcakton.”*

• Rregullimi ligjor që i detyronte nëntë anëtarë të Këshillit të Lartë të Drejtësisë të zgjedhur nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare të ushtronin detyrën me kohë të plotë u konsiderua nga Gjykata Kushtetuese si *“në kundërshtim me përmbajtjen e nenit 147 të Kushtetutës dhe me frymën e saj, sipas të cilës nëntë anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë të zgjedhur nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare janë, jo vetëm formalisht, por edhe realisht, gjyqtarë në detyrë (veprim).”*

• Kushtetuta ka bërë përjashtim, për sa i përket veprimtarisë jo permanente të gjyqtarëve në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, *“në të cilin ata përfaqësojnë trupën e gjyqtarëve që i ka zgjedhur në këtë organ kushtetues.”* Përjashtimet nga rregullimi kushtetues nuk mund të vendosen me vendimmarrje tej Kushtetutës, për arsye se vetë Kushtetutëbërësi, i ka *“konceptuar ata si gjyqtarë në detyrë...”*

• Gjykata Kushtetuese ka arsyetuar ndërmjet të tjerave se, ndryshimet e bëra në ligjin objekt shqyrtimi *“vijjnë në kundërshtim edhe me dispozitat e pandryshuara të nenit 7, pika 1/c, sipas të cilës mandati i anëtarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë mbaron kur nuk është më gjyqtar...”*

• Gjithashtu, Gjykata Kushtetuese nuk ka gjetur elementë të papajtueshëm me Kushtetutën në dispozitën ligjore që ka përcaktuar *“se anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë që zgjidhen nga Kuvendi nuk duhet të jenë gjyqtarë. Një përcaktim i tillë është në pajtim, nga njëra anë, me parimin e balancimit të pushteteve që kërkon kontrollin dhe bashkëveprimin midis tyre ashtu edhe me formulën e nenit 147 të Kushtetutës, nga ana tjetër, sipas të cilit në Këshillin e Lartë të Drejtësisë do të përfaqësohet jo vetëm gjyqësori me dhjetë anëtarë, por edhe pushteti legjislativ me tre anëtarë.”*

Është ky interpretim i kryer nga Gjykata Kushtetuese që detyroi ligjvënësin të bënte ndryshimin përkatës. Kështu, nga përmbajtja e nenit 12 të ligjit, i cili u ndryshua me ligjin nr.101/2014, nuk kishte asnjë pengesë për të zgjedhur në funksionin e zëvendës kryetarit të KLD-së edhe e njërit prej anëtarëve, që kryejnë funksionin e gjyqtarit. Në një rast eventual që Presidenti i Republikës cakton zëvendës kryetarin në radhët e anëtarëve të gjyqësorit, ky i fundit është i detyruar, bazuar në dispozitën përkatëse kushtetuese (neni 143) dhe në ligjin organik, të japë dorëheqjen si gjyqtar.

Rrjedhimisht, formula kushtetuese me prejardhje nga gjyqësori (9+1) do të shndërrohet në (8+1) dhe përbërjes kushtetuese të KLD-së do t'i mungojë një anëtar-gjyqtar. Për më tepër, kur një anëtar i KLD-së i zgjedhur nga gjyqtarët jep dorëheqjen si gjyqtar, ai nuk është më as anëtar i KLD-së (neni 7 i ligjit organik).

Neni 12 i ligjit që u ndryshua, ashtu siç ishte i formuluar e kompromenton nenin 147 të Kushtetutës, por edhe interpretimin që Gjykata Kushtetuese i ka bërë rregullimit kushtetues të përbërjes së KLD-së. Kështu, në respekt të nenit 147 të Kushtetutës dhe të jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese, neni 12 i ligjit është riformuluar, duke ndryshuar pikën 1 dhe shfuqizuar pikën 3 dhe 4.

Nevoja për këtë rregullim ligjor në ligjin organik të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, për ta konformuar atë me jurisprudencën kushtetuese, përkatësisht vendimin nr.14/2006 të Gjykatës Kushtetuese, konstatohet me kënaqësi se mbështetet dhe nga maxhoranca e djeshme dhe opozita e sotme. Pra në rrëzimin e këtij Dekreti të Presidentit të Republikës ne shpresojmë se do të kemi dhe votat e opozitës.

Kjo për faktin se kemi një precedent të krijuar gjatë ushtrimit të detyrës nga Presidenti i Republikës paraardhës. Kur ky i fundit, në vitin 2012, bëri publik vullnetin e tij për të emëruar në detyrën e Zëvendëskryetarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, njërin nga anëtarët e këtij organi, gjyqtar të zgjedhur nga Konferenca Kombëtare Gjyqësore, ministri i Drejtësisë, i maxhorancës së shkuar, opozitës së sotme, iu drejtua Presidentit të Republikës me një letër publike.

Me kënaqësi vërejmë se argumentat që radhitën në këtë raport, ndajmë të njëjtin interpretim të Kushtetutës dhe frymës së ligjit organik të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, me argumentat që përdor ministri i Drejtësisë i atëkohshëm, teksa shprehet se: *"...zgjedhja e një gjyqtari në pozicionin e Zëvendëskryetarit të KLD-së passjelllargimin e tij nga detyra e gjyqtarit dhe rrijedhimisht sjell uljen e numrit të gjyqtarëve efektivë në KLD nga 9 në 8, si dhe e transformon organizimin e përbërjen e KLD-së nga një gjendje brenda formatit kushtetues në një gjendje antikushtetutshmërie të shkaktuar prej propozimit Tuaj. Kjo nismë e Juaja, që synon nxjerrjen jashtë kornizës kushtetuese të organizimit e përbërjes së KLD-së përbën shkelje haptazi të nenit 147 pika 1 të Kushtetutës, që kërkon në përbërje të KLD-së në çdo rast 9 gjyqtarë... Është e vërtetë që në nenin 12 pika 3 të këtij ligji, ligjvënësi ka pranuar në vitin 2001 edhe rastin që Zëvendëskryetari mund të zgjidhet nga radhët e anëtarëve të KLD-së që janë gjyqtarë, me pasojën që gjatë kohës që një Zëvendëskryetar i tillë shërben në detyrë, nuk e ushtron funksionin e gjyqtarit. Mirëpo, jurisprudenca kushtetuese me natyrë legjislative, pas 5 vjetëve, solli zhvillime domethënëse në drejtim të parimeve të mirëqeverisjes dhe shmangies së konfliktit të interesave, të bazuar në ndarjen dhe balancimin e pushteteve. Konkretisht, Gjykata Kushtetuese, me vendimin e saj nr.14, datë 22.05.2006 ka analizuar posaçërisht legjislacionin për organizimin dhe funksionimin e KLD-së, nën dritën që gjyqtarët – anëtarë të KLD-së duhet të jenë në çdo rast gjyqtarë efektivë dhe të pashkëputur nga detyra e gjyqtarit. Në këtë pikë, duhet theksuar se sipas nenit 132 pika 1 të Kushtetutës, vendimet e Gjykatës Kushtetuese kanë fuqi detyruese të përgjithshme dhe janë përfundimtare për këdo në Republikën e Shqipërisë, veçanërisht për Presidentin e Republikës."*<sup>2</sup>

Në të tilla rrethana juridike, është e tepërt të pretendohet se ndryshimet e nenit 12 të ligjit organik të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, cënojnë parimin kushtetues të ndarjes dhe balancimit të pushteteve dhe atë të hierarkisë së normave, përse kohë këto ndryshime ligjore për arsyt e renditura më lart nuk kanë bërë gjë tjetër vetëm se kanë konformuar me Kushtetutën dhe jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, dispozitën përkatëse ligjore.

<sup>2</sup> <http://www.shqiptarja.com/oggetti/51148.pdf>

## 5.0 Përfundime

Pas diskutimeve të anëtarëve të Komisionit, shumica e tyre mbështeti propozimin e relatorit, duke votuar kundër dekretit dhe duke i propozuar po ashtu seancës plenare të Kuvendit të Shqipërisë që, bazuar në nenin 85, pika 2 të Kushtetutës, të votojë “kundër” dekretit nr.8679, datë 15.08.2014 të Presidentit të Republikës.

### RELATOR

Armando SUBASHI



KRYETAR

Fatmir XHAFAJ

